



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 179/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Vakati, për shkak të vendosjes së panove reklamuese në shtyllë elektrike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

KONSTATOHET tërheqja e ankesës e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ZL. A.nr. 179/2017 e datës 10.10.2017.

Arsyetim

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV,) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Vakati, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në shtyllë elektrike të kandidatit për kryetar të Komunës së Prizrenit nga radhët e këtij subjekti politik, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017.

Me datë 11.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.179/ 2017 të datës 10.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.179/2017 më datën 12.10.2017.



Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi